

# Raport mbi takimin e Qendrës së Kompetencës për konsultimin e praktikave ne menaxhimin e mbetjeve të ngurta

---

## *HYRJE*

Ne datat 4-5 Qershor, 2015, dldp organizoi së bashku me antarët e qendrës së kompetencës për menaxhimin e mbetjeve një takim konsultativ. Takimi kishte për qëllim prezantimin dhe vleftësimin e praktikave të zhvilluara nga dldp në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, siç janë: bashkëpunimi ndërvendor, riciklimi, kompostimi, gjithëfshirja në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, kampionati i riciklimit dhe përmirësimi i modelit të llogaritjes së kostos dhe tarfiës. Një çështje e rëndësishme për këtë takim ishte dhe diskutimi mbi ndryshimet në ligjin për funksionimin e Entit Rregullator të Ujit (ERRU), i cili u fokusua në kompetencat e shtuara në raport me menaxhimin e mbetjeve të ngurta.



Pjesëmarrësit në këtë workshop ishin kryesisht anëtarë aktivë të qendrës së kompetencës për menaxhimin e mbetjeve urbane (përfaqësues nga 12 NJQV, 1 Qark dhe 1 Agjensi Rajonale të Mjedisit), përfaqësues të ministrive të linjës dhe agjensive të dekoncetruara, ofruesit e shërbimeve të dldp (Coplan, URI, MIA, AGC), si dhe Shoqata e Komunave. Të ftuar në këtë takim ishin anëtarët e komisionit të ERRU dhe përfaqësues të GIZ.

Takimi u planifikua që të zhvillohej në 2 ditë të kombinuara: në ditën e pare me pjesën teorike të prezantimit të praktikave të zhvilluara dhe me sesione diskutimi dhe sqarimi, ndërsa në ditën e dytë u planifikua dhe u zhvillua një udhëtim dhe vështrim në terren të këtyre praktikave.

Qëllimi i dldp ishte që nëpërmjet diskutimeve të thelluara mbi gjetjet, të përmirësojë rekomandimet për praktikat e zhvilluara. Bazuar në numrin e praktikave dhe çështjeve për diskutim, takimi u organizua në 5 sesione.

### Sesioni I: Modeli I llogaritjes së Kostos dhe Tarifës

Change language / Ndrysho gjuhën | Shop

TË DHËNAT PËR NJQVnë

Emri i Zonës Shërbimit	Sherbimit	Popullsia e zonës (të regjistruar, por jetoj jashtë)	(mesatare ditore)	enerjimi i shërbimeve në zonën (kg/eqv. banor/dite)	Rrugët (distanca nga Landfill i një kah) (km)	Distanca për grumbullimin për kamion (km)	Koha (h) për të ngarkuar kamionin (h)	Tipi i kamionit bazuar në tipin e NJQV-së (t)	Norma e konsumit të karburantit (g/eqv. grumbullim (L/h))	Norma e konsumit të karburantit gjatë transportit (L/h)	Sigurimi i kamionit + taksat (LEK/kamion/vit)	Vaj + filtra (LEK/kamion/vit)	Goma (LEK/kamion/vit)	Mirëmbajtja mekanike (LEK/kamion/vit)	Parkim (LEK/kamion/vit)	Kostot e kamionit të mbetjeve (LEK)	Frekuenca e grumbullimit (-)	
Zona 1	Urban	208,000	0%	35,000	0.5	14	3	4	10	5	0.45	150,000	90,000	160,000	200,000	50,000	5,977,000	7
Zona 2	Rural	20,000	0%	0	0.5	7	3	3.5	12	5	0.45	150,000	90,000	160,000	200,000	50,000	6,800,000	7
Zona 3	Urban	50,000	0%	0	0.2	7	3	4	10	5	0.45	150,000	90,000	160,000	200,000	50,000	5,977,000	7
Zona 4	Urban	30,000	0%	0	0	0	0	0	0	5	0.45	150,000	90,000	160,000	200,000	50,000	6,800,000	7
Zona 5	Urban	0	0%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Zona 6	Urban	0	0%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Zona 7	Rural	0	0%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Zona 8	Urban	0	0%	0	0	0	0	0	zgjidh/select	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Zona 9	Urban	0	0%	0	0	0	0	0	zgjidh/select	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Zona 10	Urban	0	0%	0	0	0	0	0	zgjidh/select	0	0	0	0	0	0	0	0	7
Zona Riciklim	Semi Urban	10,000	0%	0	0.02	7	3	3	5	3	0.4	100,000	75,000	160,000	200,000	50,000	3,588,000	7
Zona Kompostim	Urban	23,000	0%	0	0.4	7	3	3	5	3	0.4	100,000	75,000	160,000	200,000	50,000	3,588,000	7
Totale		341,000	0%	35,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Index | Variabla fikse | Te dhenat baze | Kostot-Zona1 | Kostot-Zona2 | Kostot-Zona3 | Kostot-Zona4 | Kostot-Zona5 | Kostot-Zona6 | Kostot-Zona7 | Kostot-Zona8 | Kostot-Zona9 | Kostot-Zona10

Bazuar në diskutimin e bërë nga ekspertët e REC-ut me ekspertin ndërkombëtar të dldp Felix Schmidt dhe partnerët e dldp (NJQV-te dhe ofruesit e shërbimeve), u propozuan ndryshimet e mëposhtme në funksion të përmirësimit të këtij modeli:

- Variabla te reja fikse duke prezantuar përmasa/kapacitete të reja të kamionëve (12t dhe 15t) dhe përmasa të reja të kazanëve (1.6, 3.2, 5.0 dhe 7.0) dhe të qeseve/thasëve për shërbimin (120 kg) në ato zona ku shërbimi ofrohet pa kazanë apo shërbime riciklimi;
- Pesha e mbetjeve në kontenerë është dhënë si një miks mbetjesh dhe mbetje te riciklueshme me vete, kështu që duhet të përdoret në këtë formë në skemën e llogaritjes së riciklimit;
- Në të dhënat e NJQV-ve është përshtatur një sistem i cili është në linjë me NJQV-të e reja, ku do të aplikohen zona të ndryshme shërbimi dhe mënyra ndërveprimi. Për këtë arsye, përdoruesi mund të zgjedhë zonat respective dhe të llogaris më vete koston, duke u bazuar në numrin e popullsisë, prodhimin e mbetjeve, llojin e kamionëve, etj;

- Të dhënat e NJQV-ve kanë gjithashtu dy zona të reja të cilat mund të aplikojnë riciklimin dhe/ose kompostimin;
- NJQV-të tashmë kanë ndryshuar në tre tipologji (urbane, rurale dhe pjesërisht-urbane) dhe kanë karakteristikat e tyre, por nuk do të influencojnë direct në parametra si më parë. Është përdorur për të siguruar ngarkesën bazuar në urbane apo rurale, por tani përdoruesi mund të zgjedh vet se cilin kamion/ngarkesë të zgjedhë dhe janë 4 tipe të tilla.

## DISKUTIME

Për sa i përket modelit të përmirësuar të llogaritjes së kostos dhe tarifës, të gjithë pjesëmarrësit ranë dakort me idenë se përfshirja në sistemin e llogaritjes të zonave të shërbimit me karakteristika të ndryshme brenda së njëjtës njësi, do të ishte një ndihmë e madhe dhe përgjigje e mire për reformën territoriale. Gjithashtu, kjo do ishte një përgjigje pozitive edhe për sfidën që ka ndarja e re territoriale. Modeli i përmirësuar do të jetë një instrument i dobishëm për të zgjedhurit e NJQV-ve të reja, të cilët do të jenë përgjegjës për një territor shumë të madh se ai i NJQV-ve ekzistuese.



Duke marrë parasysh kompleksitetin e zonave, do të duhet më shumë fleksibilitet. Një element i rëndësishëm në përmirësimin e këtij modeli ishte edhe zgjerimi i llogaritjes së moduleve me riciklimin dhe kompostimin. Pjesëmarrësit që diskutuan, përtej vlerësimit të modelit të prezantuar, sugjeruan përfshirjen e elementëve të pastrimit dhe larjes së rrugëve të qytetit në modelin e llogaritjes së kostos dhe gjetjen e mundësisë për ta kaluar këtë model nga sistemi i excel-it në një aplikacion të vecantë.

Sugjerime të tjera u bënë në lidhje me sfidat e NJQV-ve të reja për të ndërtuar një bazë të dhënash të saktë, me politikatat fiskale të bashkisë në mënyrë që të mos mbikarkohen vetëm ato shtresa të popullsisë që paguajnë përherë, si dhe për të mos e bazuar barrën fiskale mbi bizneset.



Sugjerimet e tjera u bazuan në nevojën për studime të tjera të detajuara për llojin e klientëve, se si duhet të ndahet tarifa në % sipas përgjegjësisë së secilës kategori, në mënyrë që të aplikohet parimi i drejtë që ndotësi paguan.

Të gjithë pjesëmarrësit ishin të mendimit se janë të nevojshme masa shtesë për të bindur popullatën që të paguajë tarifën. Përfaqësues nga zonat e Kukësit dhe Dibrës konfirmuan se i referohen modelit të llogaritjes së kostos dhe tarifës të prezantuar nga dldp në trajnimet rajonale te Korrikut të vitit të kaluar (2014), por nuk e përdorin dhe aplikojnë si instrument.

## Sesioni II: Praktika 1: Riciklimi dhe Gjithëpërfshirja

Objektivi kryesor i këtij projekti ishte pilotimi i mundësisë për të zgjeruar mbulimin në zonat periferike (ZONA C) të mbledhjes së mbetjeve urbane në Bashkinë Lezhë, me anë të metodës derë më derë për mbetjet e riciklueshme, në mënyrë që të akomodonin kërkesat e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.



Përveç këtij fakti, projekti do të ndihmojë Bashkinë e Lezhës që të formalizojë dhe të bëjë të qendrueshme menaxhimin e Qendrës së Selektimit të Mbetjeve të Riciklueshme, e cila është operacionale që në vitin 2012, si dhe mbështet mobilizimin dhe gjithëpërfshirjen e komunitetit Rom (sektori informal) në sigurimin e një skeme të integruar të menaxhimit të mbetjeve në Lezhë.

Bazuar në punën në terren dhe të dhënat e prezantuara në tabelë, projekti e ka asistuar Bashkinë Lezhë në konsolidimin e skemës së riciklimit

Zona	Mbetje bio (t/ditë)	Të riciklueshme (t/ditë)	Totali në zonë (t/ditë )
Zona A	3	2,6	<b>5,6</b>
Zona B	2,6	2,3	<b>4,9</b>
Zona C	2	1,7	<b>3,7</b>
<b>Lezhë</b>	<b>7,6</b>	<b>6,6</b>	<b>14,2</b>

me anë të përfshirjes të të gjithë popullsisë së marginalizuar, duke i dhënë administrimin e qendrës, anëtarëve të komunitetit Rom, duke punësuar në skemën e mbledhjes anëtarë të komunitetit Rom apo të zonave të izoluar (në Zonën C, ka treg dhe pika mbledhje të mbetjeve të riciklueshme).

Z.Edlir Vokopola, ekspert i URI-t, prezantoi në mënyrë kronologjike mbështetjen e dhënë në Lezhë, përfshirjen e komunitetit Rom, masat e marra dhe menaxhimin e ri në qendrën e riciklimit e cila do të rrisë ndjeshëm sainsë e mbetjeve te riciklueshme.

	<b>Të riciklueshme (t/ditë)</b>	<b>Rekuperimi i pritshëm (%)</b>	<b>Rekuperimi ton/ditë</b>
<b>Zona C</b>	<b>1,7</b>	<b>40%</b>	<b>0,7</b>

Këto aktivitete u mbështetën nga Bashkia Lezhë me qëllim zgjerimin e mbledhjes së selektuar të mbetjeve të riciklueshme dhe rritjen e sasisë së proceseve materialeve të ricikluara. Në të njëjtën kohë Bashkia, në bashkëpunim me ofruesin e shërbimeve dhe komunitetin Rom në Lezhë, kanë rënë dakort për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për menaxhimin e Qendrës së Mbledhjes së Mbetjeve të Riciklueshme. Aktualisht, qendra menaxhohet nga komuniteti Rom, duke e rritur progresisht procesin e mbledhjes dhe sasinë e mbetjeve të ricikluara.

Duke marrë në konsideratë rekuperimin nga Zona C (një herë në javë derë më derë) dhe nga pikat e mbledhjes në qytet që vizitohen çdo ditë nga komuniteti Rom, ne mund të shohim diferencën dhe ndryshimin.

#### **DISKUTIME**

Përfshirja e komunitetit Rom në rritjen e sasisë së mbetjeve të riciklueshme duke siguruar menaxhimin komunitar të qendrës dhe formalizimin e saj, është pozitive për sistemin e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve. Në rast se do krahasojmë të dhënat, tendenca është pozitive. Vështirësitë e përballura me zgjerimin në Zonën C, janë më së shumti të lidhura me kontekstin jo të favorshëm të zgjedhjeve vendore. Nga diskutimet u rekomandua forcimi i rolit të Bashkisë në këtë sistem, si një autoritet rregullues i organizimit dhe monitorimit të sistemit. Rekomandime të tjera referuan nevojën e zgjerimit të sistemit për mbledhjen me thasë “derë me derë”, si një sistem eficient që garanton një sasi prej 450 ton/në vit të mbetjeve të riciklueshme.

#### **Sesioni III: Praktika 2: Kampionati i Riciklimit**

Z. Erion Berisha prezantoi eksperiencën e Shkodrës me kampionatin e riciklimit dhe disa rezultate të studimit të fizibilitetit. Qëllimi i këtij studimi ishte investigimi i mundësisë së krijimit të një skeme të qëndrueshme dhe instrumenti motivues – siç është vlera monetare – për të rinjtë, në mënyrë që të marrin pjesë vazhdimisht në riciklimin e materialeve që kthehen në mbetje, siç janë letra, plastika, metalet, qelqi, etj.



Në adresimin e kësaj çështjeje, studimi i fizibilitetit është fokusuar në detaje në identifikimin e:

- Aktorëve të përfshirë në mbledhjen e mbetjeve në 12 qarqet e propozuara për kampionatin
- Autoriteteve shtetërore që duhet të mbështesin skemën për arttijen e suksesit
- Analizës për gadishmërinë e këtyre autoriteteve për t'u përfshirë në këtë proces
- Qytetet potenciale që do të kualifikohen si pjesëmarrëse
- Skemës që duhet zhvilluar për organizimin e kampionatit
- Zhvillimit të skemës së menaxhimit të fondeve
- Volumit aktual të mbledhjes së materialeve të riciklueshme në të gjitha qytetet dhe studimi i tij
- Volumit real që mund të mbledhet nga nxënësit
- Analizës SWOT
- Analizës së qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të projektit për të provuar qëndrueshmërinë e skemës
- Analizës mbi fizibilitetin financiar për të krijuar këtë skemë

Pas përfundimit të studimit, realizimit të intervistave, mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, peshës së informacionit nga turneu i parë në Shkodër, AGC rekomandoi që:

Një turne mund të jetë i qëndrueshëm vetëm nëse organizohet në qytetet e:

- Tiranës
- Fierit
- Elbasanit
- Korçës
- Vlorës

- Beratit
- Gjirokastrës
- Sarandës
- Durrësit
- Lezhës
- Shkodrës

Rrethet apo qytetet e tjera që ishin subjekt i këtij studimi, mund të arrijnë në minimum pragun për një skemë të qendrueshme.

### **Rekomandime**

- Qeveria (të gjitha nivelet) duhet të mbështesin turneun që në fillim e në vijimësi. Kjo mbështetje do të vlerësohet si një investim i rendësishëm drejt edukimit të ardhshëm të të rinjve për të qenë më të përfshirë dhe të përgjegjshëm në raport me ambientin social dhe mjedisor.
- Turneu duhet të ketë ndihmën e donatorëve për të paktën 3 vitet e para, deri sa të krijojë strukturat e tij traditën dhe vazhdimësinë e mjeteve financiare.
- Një investim nga donatorët në këtë fazë, do të marrë një vlerësim të madh për paratë e shpenzuara.
- Zhvillimi i instrumenteve të duhura për të identifikuar së bashku me projektin edhe materialet e duhura promovuese, do të zhvillojë një kulturë të tillë që do ta ngrejë në nivel nacional për një kohë relativisht të shkurtër.

Qendrushmëria mund të zgjidhet ndërmjet përfshirjes së komunitetit Rom në rolin e një agjenti transportues; si i tillë, ata do të mund të garantojnë mbledhjen më ekonomike dhe në kohë, duke kontribuar në motivimin dhe pjesëmarrjen e vazhduar. Në anën tjetër, një aktivitet me të drejta të plota nga organizatorët, mund të garantojë që kampionati i riciklimit të jetë i vazhdueshëm në vitë dhe të sjellë aktorë të rinj si financues, pas mbështetjes fillestare të 3 viteve të para nga donatorët ndërkombëtarë dhe qeverisë.

### **Sesioni IV: Enti rregullator i Ujit dhe Sektori i Mbetjeve të Ngurta**

Znj. Silvana Simaku, Komisionere e ERRU, prezantoi zhvillimet në sektorin e ujit dhe sfidat që shërbimi i furnizimit të ujit të shfaqë në periudhën e tranzicionit të reformës territoriale. Ajo shpjegoi se si ERRU monitoron treguesin e performancës për ujin dhe ujërat e ndotura, si dhe marrëdhëniet e këtij institucioni me NJQV-të dhe shërbimet e furnizimit me ujë.



Gjithashtu, Znj. Simaku bëri një përmbledhje të diskutimeve dhe debateve për rolin e ERRU në të ardhmen në lidhje me sektorin e mbetjeve.

Bazuar në draft-ligjin që Ministria e Transporteve dhe Infrastrukturës ka dorëzuar në Parlament për miratim, roli i ERRU si një autoritet rregullues, do të plotësohet edhe me kompetencën e aprovimit të tarifave për shfrytëzimin e landfilleve apo mjeteve të trajtimit. Pas këtij prezantimi të shkurtër, diskutimet u përqendruan më shumë në pozicionin e ERRU, sa dhe si ky ent mund ta bëjë të detyrueshëm përdorimin e metodologjisë llogaritjes së kostos dhe tarifës për të gjithë zinxhirin e menaxhimit të mbetjeve duke filluar nga mbledhja, transporti, dhe jo vetëm për trajtimit final të tyre.

Nga diskutimet, kishte dy qendrimë të dukshme: një grup i cili e identifikoi ERRU si një Autoritet të tillë, ndërsa grupi tjetër ishte në favor për t'ja deleguar këtë autoritet me anë të një akti nën-ligjor detyrues të një nga ministratë e linjës, duke mos e specifikuar se të cila nga keto ministri - Ministria e Mjedisit apo Ministria e Transportit dhe infrastrukturës. Pjesë e këtij diskutimi ishin Komisionerët e ERRU, përfaqësues të Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës, ekspertë apo organizata si URI, Co-Plan, specialistë të NJQV-ve.



## Sesioni V: Praktika 3: Bashkëpunimi ndër-vendor dhe zgjerimi i shërbimit




Fig. 1 Përfshirja e NJQV-ve në M.M në skemën e ndër-vendore Fig 2 NJQV-të e përfshira në 2 skema në Pukë dhe F.Arrëz

Z. Redion Biba, prezantoi eksperiencën e zhvilluar në Pukë dhe Malësi të Madhe, fillimisht për të krijuar një skemë ndër-vendore dhe më vonë për procesin e ofrimit të shërbimit me anë të delegimit të shërbimit nga një NJQV të tjetra.



Më poshtë janë disa nga gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra të marra nga prezantimi i Z. Biba:

1. Skema ndër-vendore ka një potencial të mirë për të përmbushur objektivat dhe nevojat e NJQV-ve;
  - o Malësia e Madhe: pranohet që është rritur numri i popullsisë që marrin shërbim me 148%, ndërkohë çmimi për njësi pritet që të reduktohet nga 19-75% i çmimit aktual;

- Pukë- Fushë Arrëz: numri I popullsisë që merr shërbim pritet që të rritet me 20%, ndërsa çmimi për njesi pritet që të reduktohet me 8-81 % nga çmimi aktual;
  - Reduktim i vend-depozitimeve ilegale;
  - Inisiativa lokale, si kompostimi;
2. Niveli i partnershipit ndërmjet NJQV-ve ka qenë I kufizuar për shkak të:
    - Potencialeve për të përfituar nga skema
    - Mungesa e burimeve dhe vullneti për bashkëpunim
    - Mbështetja institucionale
  3. Zhvillimi i skemës së nevojave ndër-vendore;
    - Vlerësim I përbashkët i përfitimeve nga të gjitha palët e përfshira;
    - Përfshirja e të gjitha palëve qënë fillim të procesit, duke siguruar interes, konsensus dhe transparencë;
    - Përveçkapaciteteve lokale të partnerëve, roli i tyre në vendim-marrje duhet të respektohet;
    - Ndërtimi i konsensusit që në fillim me aktorët më të interesuar;
  4. Pritshmëritë, paqartësitë dhe përgatitjet për implementimin e reformës së ndërprerë për skemën e ndër-vendore;
  5. Përveç kësaj, NJQV-të të cilat janë pjesë e këtij procesi, tani janë gati për tu futurë në një fazë të re të bashkëpunimit pas reformës territoriale, pasi:
    - Është treguar interes për të bashkëpunuar dhe përmirësuar shërbimin;
    - Kapacitetet lokale janë rritur dhe procesi I vendim-marrjes është lehtësuar;
    - Mbështetja institucionale për të zhvilluar skemë të përbashkët;
    - Instrumentet e planifikimit financiar (modeli i kostos dhe tarifës) do të lehtësojnë procesin e vendim-marrjes për të filluar menjëherë skemën e përbashkët të ofrimit të shërbimit;
    - Proceset e zhvilluara gjate bashkëpunimit ndër-vendor do të implementohen në këtë sektor pas reformës territoriale (depozitimi, stacionet e transferimit, qendrat e riciklimit, skemat e përbashkëta, etj)

#### **DISKUTIME:**

Në këtë session, diskutimet u fokusuan kryesisht në rekomandimet e duhura për të arritur integritet të shërbimit në të gjitha njesitë administrative të reja të një bashki të re të madhe pas zgjedhjeve vendore të 21 Qershorit, duke u përpjekur për t'i dhënë përgjigje sfidave të tilla, siç është organizimi i shërbimit në shkallë graduale apo menjëherë në të gjitha njesitë, kontraktikimi i përbashkët apo i veçantë i ofruesve të shërbimit, tarifa të barabarta apo të diferencuara për zona të ndryshme, monitorimi i shërbimit nga bashkia qendrore, apo delegimi te përfaqësuesit e njësive administrative.

Diskutime të shumta u bënë edhe për sa i përket çështjes së përgjegjësisë në nivel të bashkisë qendrore apo njesisë administrative të organizimit të shërbimit nga bashkia e re, pas reformës territoriale.

Për supervizimin e shërbimit u dhanë 2 propozime:

1. Caktimi i një punonjësi nga bashkia e madhe për të monitoruar shërbimin në të gjithë territorin, sic janë aktualisht supervisorët, ose

2. Një punonjës për çdo njesi administrative, i cili vlerëson nevojat bazë dhe kujdeset për cilësinë e shërbimit.

Për sa i përket integritit e shërbimit, në rast se NJQV-të preferojnë që të bëjnë një kalim agresiv (të menjëhershëm) apo gradual të fazës së tranzicionit deri në integrimin e shërbimit nga kontrata të ndryshme, mendimet konsistuan në:

- Në rastin kur kemi kontrata të ndryshme, duhet të ndërpresim dhe të fillojmë nga e para, ose
- Gradualisht, të mbyllim kontratat ekzistuese. Mendimi i dytë pati më shumë konsensus nga pjesëmarrësit.

Çështja e fundit që u diskutua në lidhje me integrimin e shërbimit lidhet me procesin e kostos dhe tarifës për të gjitha NJQV-të ekzistuese dhe nesër, pjesë e një bashkie të madhe. Përveç kostove të ndryshme në zona të ndryshme, opinioni kryesor ishte për të të patur një tarifë. Për sa i përket propozimit për tarifa të diferencuara për zona të ndryshme (njesitë administrative) brenda të njëjtës NJQV, pjesëmarrësit theksuan rendësinë e një sistemi të mirë monitorues dhe transparent, si një parakusht për politikën fiskale të kryetarëve të rinj që do të zgjidhen.

#### **Sesioni VI: Praktika 4: kompostimi bujqësor dhe invididual**



Dita e dytë e takimit u zhvillua në ambientet e qendrës komunitare në fshatin Shirq të komunës Dajç, Bregu i Bunës. Në këtë sesion u prezantuan 2 praktika të zhvilluara për kompostimin bujqësor në Dajç nga Millieukontakt Albania dhe (komunitetit) kompostimi individual në Pukë, i zhvilluar nga Co-Plan. Nga krahasimet e gjetjeve të të dy grupeve të ekspertëve, secili prej pjesëmarrësve pati mundësi të familjarizohet me avantazhet e disavantazhet e secilit prej aplikimeve të kompostimit. Prezantimet e eksperiencave të mira në Dajç, përveç gjetjeve teorike u shoqëruan me një vizitë në një nga fermat të cilat janë pilotuar për këtë model.



Znj.Valbona Mazreku dhe Znj.Rrezearta Ago nga Millieukontakt Albania prezantuan:

#### **Kompostimi bujqësor në Dajç:**

Studimi i fizibilitetit tregon potencialet ekonomike të kompostimit bujqësor në ferma, duke përfshirë edhe kostot e investimit dhe marketingut. Ky dokument ka për qëllim që të kapitalizojë sfidat dhe mundësitë e integritit të kompostimit me aktivitete të tjera të fermave, si dhe të rrisë qendrueshmërinë e forcës së punës. Një objektiv tjetër i këtij studimi i cili do të jetë gati në fund të muajit Qershor, është që të analizojë kërkesat teknike dhe ekonomike të metodës aktuale të kompostimit.

## Kompostimi individual përkundrejt kompostimit në nivel fshati

Deri më sot kompostimi është bërë në nivel individual/bazë fermash. Në momentin kur të arrihet një standart më i lartë në marrëdhënie me biznesin, atëherë nevoja për të krijuar një grup më të madh në bazë familjeje apo komuniteti/fshati do të jetë e domosdoshme.

## Rekomandime

- Minimizim të kufizimeve rregullatore në lidhje me kompostimin bujqësor;
- Sigurim të mbështetjes (qendrore/locale) për pajisjet e kompostimit dhe përgatitjen e materialit të depozituar (kostot e depozitimit, stimujt ekonomike, etj.);
- Zhvillim të mëtejshëm i procesit të kompostimit nga fermerët;
- Mbështetje të programeve kërkimore dhe demonstrimi i tyre, i cili jep mundësinë për të eksploruar aplikime në kompostim, veçanërisht në sektorin bujqësor;
- Vazhdim të trajnimit aktiv për fermerët, përkundrejt trajnimeve pasive;
- Aktivitete ndërgjegjësuese me të gjithë aktorët mbi faktin se kompostimi është një proces që i shërben komunitetit dhe ambientit;
- Pilotimi i inisiativave duhet të jetë një shembull për të kaluar nga kompostimi individual brenda fermave, në nivel lagjeje apo fshati.

Redion Biba nga Coplan, prezantoi rezultatet e para dhe hapat e mëtejshëm të inisiativës së filluar në Pukë për kompostimin në nivel komunitar.

## Mundësi dhe Sfida:

- Zgjerim të mëtejshëm të komunitetit të kompostimit?
- Njohuri dhe ndërgjegjësim, Shkolla dhe vullnetarë...
- Përfshirje të biznesit local, skemë "win-win"...
- Reduktim të tarifave, investimet fillestare
- A mundet që komuniteti i kompostimit i bazuar në lagje/fshat të jetë një zgjidhje afat gjatë?

## Hapat e mëtejshëm:

1. promovim
  - o Media
  - o Faqe web
  - o Fushata sensibilizuese
2. Angazhimi i palëve të interesuara:





- Familjet – komunikimi
- Shkollat, Drejtoritë Rajonale Arsimore
- Bizneset/ekonomitë locale (AgroPuka)



Foto 3 Kompostimi në Dajç, Shkurt 2015



Foto 4 Kompostimi në Dajç, Qershor 2015



#### Aneksë:

Aneks 1: Axhenda e aktivitetit të 4-5 Qershorit 2015

Aneks 2: Lista e pjesëmarrësve

Aneks 3: Prezantimet

# WORKSHOP

Mbi prezantimin dhe konsultimin e 4 praktikave të zhvilluara në sektorin e mbetjeve urbane  
[Rrjeti i Ekspertëve Ndër-Vendor]

Velipojë, 4-5 Qershor 2015  
Hotel Godija, Velipojë  
[[www.hotelgodija.com](http://www.hotelgodija.com)]

## PROGRAMI

Koha	Çështja
<b>E Enjte, datë 4 Qershor 2015</b>	
<b>09:00</b>	<b>Grumbullimi i Grupit para Hotel Turizimit – Shkodër dhe Nisja për në Velipojë<sup>1</sup></b>
09:30 – 10:00	Mbërritja dhe regjistrimi/akomodimi në hotel
	Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe Kafeja e mirëseardhjes
<b>Sesioni I</b>	
<b>Modeli i llogaritjes së kostos dhe tarifës</b>	
	Të ftuar: Ambasada e Zvicrës/SDC, Ministria e Mjedisit, ERRU, organizatat partnere
10:00 – 10:15	Fjala hapjes dhe objektivat e workshopit
10:15 – 11:30	Modeli i dldp për llogaritjen e kostos dhe tarifës. Plotësimi i tij me gjetje nga zbatimi në terren. <b>Eksperiencat prezantohen nga Arben Kopliku - dldp / Eduart Cani - REC</b>
11.30 - 12.00	Pyetje dhe diskutime
12:00 – 12:30	Pushim
<b>Sesioni II</b>	
<b>Praktikat e riciklimit dhe përfshirja sociale</b>	
12:00 – 12:45	Zgjerimi i shërbimit në zonat periferike dhe mbështetja e iniciativave për riciklimin në bashkinë Lezhë <b>Eksperiencat prezantohen nga Edlir Vokopola - URI</b>
12:45 – 13:15	Gjetjet nga studimi i fizibilitetit për kampionatin e riciklimit <b>Eksperiencat prezantohen nga Erion Berisha – AGC</b>
13.15 – 13.45	Pyetje dhe diskutime
<b>Pushim dreke</b>	
<b>Sesioni III</b>	
<b>Praktikat e bashkëpunimit ndërvendor dhe shtrirja e shërbimit</b>	
15:00 – 15:30	Gjetjet nga zbatimi në praktikë i mbështetjes së bashkëpunimit ndërvendor në njësitë vendore të Malësisë së Madhe dhe Pukës <b>Eksperiencat prezantohen nga Redion Biba dhe Teida Shehi, Coplan</b>
15.30 – 15.30	Pyetje dhe diskutime
15:30 – 16:00	<b>Pushim Kafeje</b>
<b>Sesioni IV</b>	
<b>ERRU dhe sektori i mbetjeve</b>	
16.00 – 16:30	Projektligji për kompetencat që duhet të ketë ERRU edhe për sektorin e mbetjeve <b>Tbd- ERRU</b>
16:30 – 17:00	Pyetje dhe diskutime <b>Diskutim i moderuar nga Valbona Karakaçi - dldp</b>
17.00	Mbyllja e ditës së parë të workshopit
<b>20.00</b>	<b>Darka e përbashkët</b>

<sup>1</sup> DLDP do vejë në dispozicion një autobus nga Shkodra (Hotel Turizmi) në Velipojë

<b>E premte, datë 5 Qershor 2015</b>	
07:00 – 09:00	Mëngjesi ne ambientet e Hotelit
09:00	Largimi nga ambientet e Hotelit.
09.00-10.00	Udhëtim me autobus nga Velipojë në Dajç të Bregut të Bunës (qendra komunitare Shirq)
<b>Sesioni V</b> <b>Praktikat e kompostimit individual dhe bujqësor<sup>2</sup></b>	
10.00-10.15	Fjala e hapjes, Kryetari i Komunes Dajç
10.15-10.30	Pershendetje nga perfaqesues te Ministrise se Mjedisit
10.30-11.45	Praktikat e kompostimi bujqësor zhvilluar në komunën Dajç i Bregut të Bunës. Gjetjet dhe rekomandime nga zbatimi i tij në praktikë. <b>Eksperiencat prezantohen nga Valbona Mazreku, Rrezearta Ago – Millieukontakt Albania</b>
11.45-12.15	Praktikat e kompostimi individual në bashkinë Pukë. Sfidat dhe mundësitë. <b>Eksperiencat prezantohen nga Redion Biba – Coplan</b>
12.15 – 12.30	Pushim
12.00-13.15	Vizitë në disa prej fermave ku është aplikuar modeli i kompostimit në Dajç
<b>13.30 – 15.00</b>	<b>Drekë e përbashkët në Shkodër</b>
15.00	Mbyllja e aktivitetit

**Shënim:** Të gjitha shpenzimet e këtij aktiviteti do të mbulohen nga DLDP.

<sup>2</sup> Aktivitet ne kuader te 5 Qershorit, Dites se Mjedisit



Liste e pjesemarrësve ne wsh per menaxhimin e mbetjeve urbane (Qendra e kompetences)

Velipoje, 4-5 Qershor 2015

Nr.	Emri mbiemri	Institucioni	Pozicioni	Tel/cel	email
• 1	Sinoli Dilo	Ministria e Zhvill. Urban	Specialiste	0696150310	Sinoli_dilo@zhvillimiurban.gov.al
2	Redion Bibe	Co-Plan	Manaxhi. program	0684056387	redion_silva@co-plan.org
3	Orion Soulu	MILIEUKONTAKT	SPECIALIST	0696110400	orion.soulu@milieucontact.org
4	Mouika Vejseli	GIZ Albania	Coordinator	0672294166	mouika.vejseli@giz.de
5	FLAMUR THAQI	B. KRUMË	ZYKRYETAR	0692499290	flamurthaci@yahoo.com
6	ZENULLA MEHMETI	BARZAN DIBER	SHËP. SEKTORIT	0673840009	mehmeti68@yahoo.com
7	Albert Çollaku	B. Klos	ZYKRYETAR	0682358240	bertcollaku@yahoo.com
8	OLTIGNA HILAJ	DRM- KUCES	Spec. Depesh. K. V. N. M.	068328645	oltonahilaj@yahoo.com
9	Redmond Jurici	Bashkia Puljez	Drejtor	0685514367	redmond_jurici@live.com
• 10	Fatbardh Kusi	Bashkia Shkoder	Drejtor Shkoder	0665502058	fatbardhkusi@yahoo.com
11	Pleninda Inoja	DLDP	PA		
12	Arben Koplaku	DLDP	DPM		
13	ERTON KASHTA	DLDP	DPM		
• 14	ERNEST MORLA	BASHKIA LEZHE	Supervisor	0684516996	ernestmorla@yahoo.com
15	Rezarta Hoxha	Milieucontact	menaxhues	068904214	rezartas@milieucontact.com
16	Valbona Mazerani	—	Drejteshe	0682065353	valbona.mazerani@milieucontact.org
17					



Liste e pjesemarrësve ne wsh per menaxhimin e mbetjeve urbane (Qendra e kompetences)

Velipoje, 4-5 Qershor 2015

Nr.	Emri mbiemri	Institucioni	Pozicioni	Tel/cel	email
1	Florenc Hyka	Kom. Xhafzotaj	Specialist	0662378733	flori_hyka@yahoo.com
2	Isa Memia	Ministria e Transportit	Spesudis	0672080170	isa.memia@transporti.gov.al
3	Gjovardin Sedaj	Shërbimet	Kom. Sekret	0685764556	gjovardinedej@hotmail.com
4	ENDRIT KRAYA	BASHKIA PUKË	JURIST	0674014977	endrit.kraya@yahoo.com
5	Agron HAXHIMALI	SHKUSH	Direktor	0682050310	agore@abcom.qi
6	Riza Ajdini	ERRU	Komisioner	0682060357	riza.ajdini@erru.al
7	Fatime Imeraj	ERRU	Komisioner	0682010772	fatime.imeraj@erru.al
8	Silvana Simaku	ERRU	Ant-Komision	0682090082	silvana.simaku@erru.al
9	Etleva Demiri	ERRU	Pergj. Sektori Teknik	0692057311	etleva.demiri@erru.al
10	EDLIR VUKODOLLA	URI	Staff	0692092841	edlirvukolla@cen.op.al
11	Entela Kallamata	URI	Staff	0699360144	ekallamata05@yahoo.com
12	Erion BERISHA	AGC	Staff	0694060812	erion.berisha@fmail.com
13	KREUZA LEKA	AGC	Staff	0694060820	kreuzaleka@gmail.com
14	Bekta Alescu	Bashkia PUKË	Pergj. Sek. Sherb.	0674014991	bekta.alescu@yahoo.com
15	Gamil Brahimi	Bashk. F. Arroz	Pergj. Sek. Sherb.	0682517834	gamil.brahimi@gmail.com
16	Ardyona Krasniqi	DRM SHKODER	Specialiste	0693803467	ardiyona.krasniqi@gmail.com
17	Erben Brojaj	D. R. M. SHKODER	SPECIALIST	0674321142	erbenbrojaj@gmail.com